



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE

VLORE

NR. 384 Akti'

NR . 428 Vendimi

Data e regjistrimit 13.01.2016

Date 30.03.2016

VENDIM

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Sot me date 30.03.2016, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar nga sekretaria gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dÿer te hapura çështjen civile me Nr. 384 akti date 13.01.2016 qe i përket:

**PADITES:** Subjekti "Gjergji Llazi", me nr. Nipt L53303016J, përfaqësuar prej Z.Gjergji Llazari i datëlindjes 09.08.1985. I biri i Dhimitraqit dhe Rozetes, lindur ne Berat dhe banues ne Berat me adrese Lagja "Donika Kastrioti", Rr. Antipatrea, godine 1-kateshe, i perfaqesuar vete ne gjykim.


**I PADITUR:**Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat, Rruga "Anpitatrea", Berat, (Ne mungese).

Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Rruga Gjin Bue Shpata, Tirane, (Ne mungese).

R



RR 172 720 322 AA



**PERSON I TRETË:** Avokatura e Shtetit Dega Vlore. (Ne mungese).

**OBJEKT:** Shfuqizimin/Anulimin e aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" Dënim me Gjoke Nr. 4702/96 prot, date 25.09.2015 te pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, lëne ne fuqi nga Drejtoria e Apelit Tatimor përmes Vendimit Nr. 32395/1 Prot., date 13.12.2015;

**B.LIGJORE:** Ligji 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative...*"; Kodi Procedurave Administrative; Ligji 9920/2008 "*Per procedurat tatimore ne RSH*".

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi dëgjoji paditësin i cili kërkoi pranimin e padisë sipas objektit , i paditurit –ne mungese dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne tërësi, si përfundim,

### **VEREN**

Se para Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Vlore pala paditëse Subjekti "Gjergji Llazi" ka paraqitur një padi me objekt si me sipër. Gjykata çmon se kjo padi është ne kompetencën funksionale te kësaj gjykate konform nenit 10/1 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit përcaktohet se : "*Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ*".

Gjykata çmon se është ne kompetencën lëndore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi padia është një prej atyre te parashikuara ne nenin 7/a te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit rezulton se : "*a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore*

*normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik”.*

Gjithashtu gjykata çmon se është ne kompetencën tokësore të kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi sipas nenit 11/1 të Ligjit Nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” në baze të të cilit rezulton se : *“Padi të kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet”*. Pasi e paditur në këtë proces është Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor rezultoi se: Subjekti Gjergji Llazi me nr. Nipt L53303016J. është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat *“Shërbime të tjera të pastrimit e të menaxhimit të mbetjeve”*. me adrese të aktivitetit në lagjen. Lagja “Donika Kastrioti”. Berat. Subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore me objekt padije *“Shfuqizimin e akteve administrative ”* në lidhje me njoftim vlershmin nr. 4702/96 date 25.09.2015.

Me ane të Njoftim Vleresimit nr. 4702/96 date 25.09.2015 dërguar nga DRT Berat subjektit i është komunikuar penalteti në vlerë 50.000 (pesedhtjete) mijë leke për mospasje me kase fiskale, bazuar në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar. neni 122 pika 1 germa a,i.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrative për detyrimet tatimore Njoftim Vlershmit nr. 4702/96 date 25.09.2015, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tirane, e cila me vendimin nr.32395/lprot date 15.12.2015 (prot me DRT Berat me nr.6798 date 17.12.2015) ka vendosur: *“Lenin në fuqi të aktit administrative Njoftim Vlershmin për detyrimet tatimore nr. 4702/96 date 25.09.2015 nxjerre nga DRT Berat”*

Ligji i zbatueshëm është Ligji nr. 9920 date 19.05.2008. *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar. Udhëzimi nr. 24 date 02.09.2008. *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, VKM nr.781.date 14.11.2007 si dhe ligji nr.49/2012 *“Per*

Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmareveshjeve Administrative"

Vlerësimi tatimor është rrjedhojë e penalizimit si rezultat i kontrollit të ushtruar në subjektin Gjergji Llazi nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat të cilët kanë mbajtur akt-konstatim me nr. serial 05388068, datë 23.09.2015, ku u konstatua se subjekti nuk është i pajisur me pajisje fiskale.

Nga kontrolli i ushtruar në subjektin Gjergji Llazi është mbajtur Akt-Konstatimit me nr. serial 0538806. datë 23.09.2015. në të cilin ndër të tjera shprehet se:

*" Subjekti është i regjistruar në OKR Berat në dt. 03.09.2015 dhe nuk është i pajisur me pajisje fiskale....*

....

...

*Kontrrolli u mbyll në orën 09:30".*

Akti i konstatimit është i firmosur nga inspektorët tatimor të cilët kanë kryer kontrollin në subjekt si dhe është firmosur edhe nga vet përfaqësuesi ligjor i subjektit Gjergji Llazi.

Në vijim të procedurës është mbajtur Procesverbali i gjobës nr.0183458 dhe me pas është nxjerre akti administrative. Njoftim Vlerësimi Nr.4702/96 datë 25.09.2015. që ka penalizuar subjektin me gjobe në vlerën 50 000 leke.

Gjoba e nxjerre nga ky Njoftim-vlerësim në vlerën 50.000(pesëdhjete mijë) leke për mos instalim të pajisjes fiskale është i bazuar në ligjin Nr.9920. datë 19.05.2008 "*Për Procedurën Tatimore në Republikën e Shqipëri*". i ndryshuar dhe me konkretisht në nenin 122 pika 1 germa a-i. ( dhe akteve nënligjore në zbatim të tij) ku përcaktohet se :*122.1 Tatimpaguesi. person juridik ose fizik. tregtar, dënohet në rast se:a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:i) herën e parë të konstatimit të mos instalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobe në masën 50 000 (pesëdhjete mijë) leke:Për tatimpaguesit e*

*regjistruar për here te pare ose qe plotësojnë për here te pare detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit te monitorimit te qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit te monitorimit te qarkullimit:*

Ne akt - konstatim nder te tjera shprehet se: "*Subjekti është i regjistruar ne QKR Berat ne dt. 03.09.2015 dhe nuk është i pajisur me pajisje fiskale "*

*Instalimi dhe funksionimi i kësaj pajisje përcaktohet ne mënyre te detajuar ne VKM nr.781 date 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike e funksionale te paisjeve fiskale sistemit te integruar te kompjuterizuar për transmetimet periodike automatike te deklarimeve financiare sistemit te komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim te shoqërive te autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale"*

Ne VKM nr.781 date 14.11.2007 pika 1 përcakton qartësisht detyrimin e tatimpaguesit për instalimin e pajisjeve fiskale.

*"Detyrimi për instalimin e paisjeve fiskale;*

*Tatimpaguesit, qe kryejnë qarkullimin e mallrave dhe te shërbimeve për te cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës ose ne sektorët e veçante te përcaktuar ne këtë vendim apo ne udhëzimet e Ministrisë se Financave janë te detyruar te përdorin paisje apo sisteme fiskale, për regjistrimin e qarkullimit. duke lëshuar kuponin tatimor".*

Detyrimi për te instaluar dhe përdorur pajisjet fiskale përcaktohet ne ligjin Nr.9920. date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipëri"i ndryshuar neni 55 "Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale" ku citohet:

*"- Tatimpaguesit. qe kryejnë qarkullimin e mallrave dhe te shërbimeve për te cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë te detyruar te fusin dhe te përdorin sistemin fiskal nëpërmjet përdorimit te pajisjeve fiskale. për regjistrimin e pagesave me para ne duar dhe për lëshimin ne mënyre te detyrueshme. te kuponit tatimor.*

*-Këshilli i Ministrave miraton karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, te sistemit te integruar te kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, te sistemit te komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me autorizim te shoqërive qe ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes se autorizimit për këto shoqëri.*

*-Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim te pajisjeve fiskale elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancën e ruajtjes se kuponit tatimor dhe rregulla per mirëmbajtjen e lyre teknike e te shërbimit".*

Udhëzimit Nr.24 date 02.09.2008 ne zbatim te ligjit, Kreu VI.pika 55 ku thuhet se: *"Personal e tatueshëm subjekte te tatimit mbi vlerën e shtuar apo te tatimit mbi fitimin dhe personal e tatueshëm, subjekte te taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit mbi te ardhurat janë te detyruar te pajisen te përdorin dhe mirëmbajnë pajisjet fiskale ne përputhje me dispozitat e Vendimit te Këshillit te Ministrave Nr. 781. date 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale. sistemit te integruar te kompjuterizuar për transferimet periodike, automatik te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim te shoqërive te autorizuarra për ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve te tjera nënligjor ne zbatim te tij".*

Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr. 781, date 14.11.2007. ne lidhje me regjistrimin e qarkullimit përcakton se: *"Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice qe shesin mallra apo ofrojnë shërbime ne mjedise, apo njësi te përhershme te hapura me publikun, instalojnë pajisje fiskale dhe lëshojnë kuponë tatimore për çdo transaksion".*

Për sa është parashikuar me larte pala paditëse ka ushtruar aktivitetin tregtar e saj tregtar ne kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9920/2008 si dhe akteve nënligjore ne fuqi, duke mosperdorur kësen fiskale konforme kushteve dhe rregullave te përdorimit ne kryerjen e veprimeve tregtare.

Përsa është cituar me lart si dhe referuar Ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar )ne nenet e sipërpërmendura, Udhëzimit Nr.24 date 02.09.2008 ne zbatim te ligjit, Kreu Vl.pika 55 si dhe VKM-se Nr.781.date 14.11.2007i ndryshuar është e përcaktuar qarte gjoba për mosinstalim te pajisjes fiskale.

Ne piken 80.03 c) te Udhëzimit nr.24. date 02.09.2008 ne zbatim te ligjit është përcaktuar se:"Verifikimet ne vend; Keto verifikime te shkurtra synojnë zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshëm (identifikimin e personave te paregjistruar) me përdorimin e pajisjeve fiskale me përdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin falurave tatimore etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshëm por velem nëpërmjet prezantimit ne momentin e verifikimit te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e ditës te lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë se kontrollit per verifikime ne vend.

Për sa me sipër aktet administrative Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 4702/96 date 25.09.2015 i DRT Berat dhe Vendimi Nr. 32395/1 date 13.12.2015 te Drejtorisë se Apelit Tatimor Tirane janë te mbështetur ne ligj, si dhe mbështetur ne Legjislacione e sipërpërmendura . Ne nenin 331/1 te Kodit te Procedurës Civile dhe nenin 40 pika 3 te Ligjit me nr.49 date 03.05.2012. "Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

Për sa me sipër gjykata vlerëson se padia nuk është e mbështetur ne prova dhe ne ligj dhe si e tille duhet te rrezohet .

#### **Për këto arsye**

Gjykata ne baze te Ligji 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative...*";Kodi Procedurave Administrative; Ligji 9920/2008 "*Per procedurat tatimore ne RSH*" si dhe Udhëzimit Nr.24 date 02.09.2008:

**VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesepadisë si të pabazuar në ligj dhe në provë.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
3. Ndaj këtij vendimi nuk lëshohet urdhër ekzekutimi .
4. Vendimi është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi.

U shpall në Vlorë 30.03.2016.

**SEKRËTARE**  
**KAMILA PETRITI**



**GJYQIAR**  
**KENDHIMA**

